



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 16 datë 20.2.2023

“PËR NJË NDRYSHIM NË BUXHETIN E VITIT 2023, E MIRATUAR ME VKB NR. 71, DATË 27.12.2022 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2023 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PËRFUNDIMTAR 2023-2025 TË BASHKISË SHKODËR”

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 20.2.2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të neneve 23 dhe 54 pika “dh” të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; Ligjit nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”; Ligjit 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar; Ligjit nr.68/2017 ‘Për financat vendore’, i ndryshuar, Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 “Mbi procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit”, të ndryshuar; Ligjit nr. 84, datë 24.11.2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, VKB Nr.71 datë 27.12.2022 “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor Afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë së Shkodrës”; Marrëveshjes së bashkëpunimit mes Bashkisë Shkodër dhe Ministrisë së Mbrojtjes”, si dhe relacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër:

V E N D O S I:

1. Të miratojë fondin prej **1,071,952 lekë** për ndërhyrje emergjente të detajuar si më poshtë:
 - a) Ndërtim mbështetëse dhe shtresë dërrasash për urë tip Beili Rragam në vlerën **686,952 lekë**.
 - b) Shpenzime për dieta në vlerën **385 000 lekë**.

2. Burimi i financimit do të jetë buxheti i Bashkisë Shkodër i miratuar me VKB -në nr. 71 datë 27.12.2022 “ Per miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe Programit Buxhetor Afatmesem perfundimtar 2023 -2025 te Bashkise Shkodër”, në fish programin P03280.Q1.O1.A1. Struktura e mbrojtjes civile dhe organizimi i strukturave vullnetare në Bashkinë Shkodër, A1 Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile si më poshtë:

Pakësime				leke	
Nr	Nr. Programi	Programi	Projekti Emërtimi	Artikulli 604 TRANSFERIME KORRENTE TE BRENDESHME	Institucioni
1	3280 (Transfer të e pakushtëzuar)	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	P03280.O1.A1 “Struktura e mbrojtjes civile dhe organizimi i strukturave vullnetare të Bashkisë Shkodër P03280.O1.A1/A.1 ”Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile”.	1,071,952	Bashkia Shkodër
		TOTALI		1,071,952	

Shtesa				leke		
Nr	Nr. Programi	Programi	Projekti Emërtimi	Artikulli 602 MALLRA DHE SHERBIME TE TJERA	Artikulli 231 SHPENZIME PER RRRITJEN E AKTIVEVE TE QENDRUESHME TE TRUPEZUARA	Institucioni
1	3281 (Transfertë e pakushtëzuar)	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	P03280.O1.A1/A.1 Ndërtim mbështetëse dhe shtresë dërrasash për urë tip Beili Rragam.		686,952	Bashkia Shkodër
2	3282 (Transfertë e pakushtëzuar)	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	P03280.O1.A1/A.2 Shpenzime për dieta	385,000		Bashkia Shkodër
		Shuma		385,000	686,952	
		TOTALI		1,071,952		

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015
“Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

K R Y E T A R


Brisela KADIJA



Sekretari i Këshillit Bashkiak


Denis Lesha

Miratuar me 28 vota

Vota Pro 28

Vota Kunder 1

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 22.2.2023